

Fjala e Paqes



*Pjetri tha:
ju e kryqëzuar dhe e vratë...
por Hyu e ngjalli
duke e shpëtuar
nga tmerrri i vdekjes.
(Vap 2, 23-24)*

Lajmëtar fetaro-kulturor i Arqipeshkvisë Metropolitane Shkodër - Pult **Nr. 2 (127) Viti XVIII Shkurt-Mars 2016**

PAPA FRANÇESKU NË MEKSIKË



Papa Françesku bëri udhëtimin Apostolik në Meksikë me 12-18 shkurt 2016. E martë, 16 shkurt 2016, në takimin me të rinjtë, në stadiumin “José María Morelos y Pavón”, Morelia, pati Fjalimin që vijon:

Mirëmbërma! Juve, të rinj të Meksikës që jeni këtu, që jeni duke shikuar nëpërmjet televizionit, që jeni duke dëgjuar... Dhe dua t'u dërgoj një përsëritje të një bekimi edhe mijëra të rinjve të dioqezës së Guadalarës që janë mbledhur në Sheshin Shën Gjon Pali II për të ndjekur atë që po ndodh këtu; e si ata edhe shumë të tjerë, por më kanë informuar se atje ishin mbledhur me mijëra e mijëra duke dëgjuar. E kështu jemi dy “stadione”: Gjon Pali i Guadalarës dhe ne këtu, e pastaj edhe shumë të tjerë nga të gjitha anët.

I njihja pritshmëritë tuaja, sepse më keni dërguar skicën e asaj që pak a shumë do të thoshit... – është e vërtetë! Pse duhet t'ju gënjej? – Por, ndërsa po flisnit merrja shënim disa gjëra që më dukeshin të

rëndësishme për të mos i lënë pezull...

Ju them se, kur arrita në këtë tokë, u prit nga një mirëseardhje e ngrohtë, dhe munda të vërej menjëherë një gjë që e dija prej kohësh: gjallërinë, harenë, shpirtin e gëzueshëm të Popullit meksikan. Tani, pasi ju dëgjova, por sidomos pasi ju pashë, po vërej përsëri një tjetër siguri, një gjë që ia thashë Presidentit të Kombit në përsëritje time të parë. Njëri prej thesareve më të mëdha të kësaj toke meksikane e ka fytyrën të re, janë të rinjtë e saj. Po, jeni ju pasuria e kësaj toke. Kujdes: nuk thashë shpresa e kësaj toke, thashë: pasuria.

Mali mund të përmbajë minerale të çmueshme që mund të shërbejnë për përparimin e njerëzimit: është pasuria e tij, por ajo pasuri duhet të shndërrohet në shpresë me anë të punës, siç bëjnë minatorët kur i nxjerrin ato minerale. Ju jeni pasuria, duhet që ajo të shndërrohet në shpresë. Dhe Daniela në fund parashtroi një sfidë, e na dha edhe shenjë, në lidhje me shpresën, por të gjithë ata që folën, kur theksonin vështirësitë, situatat, pohonin një të vërtetë shumë të madhe, pra se të gjithë mund të jetojmë por nuk mund të jetojmë pa shpresë. Të ndiejmë të nesërmen. Nuk mund të ndihet e nesërmja nëse më parë njeriu nuk arrin të ketë vlerësim për vetveten, nëse nuk arrin të ndiejë se jeta e tij, duart e tij, historia e tij kanë një vlerë. Të ndiejmë atë që Alberti thoshte: “Me duart e mia, me zemrën time dhe me mendjen time mund të ndërtoj shpresën; nëse unë nuk e ndiej këtë, shpresa nuk do të mund të hyjë në zemrën time”.

Shpresa lind kur mund të përfjethet se jo gjithçka ka humbur. Dhe për këtë është e nevojshme të fillohet “nga shtëpia”, nga vetvetja. Jo gjithçka ka humbur. Unë nuk kam humbur. Unë vlej, unë vlej shumë. Ju kërkoj heshtje tani; secili të përgjigjet në zemrën e vet: A është e vërtetë se jo gjithçka ka humbur? Unë a jam i humbur, a jam e humbur? Unë a vlej? A vlej pak? A vlej shumë? Kërcënimi kryesor ndaj shpresës janë bisedat që të zhvlefësojnë, sikur ta thithin vlerën, dhe sikur përfundon përtokë – a nuk është e vërtetë? – si i vyshkur, me zemrën të trishtuar... biseda që të bëjnë të ndihesh i klasit të dytë, nëse jo i së katërtët. Kërcënimi kryesor ndaj shpresës është ajo që ndien se askujt nuk i intereson për ty ose se je i lënë mënjanë. Kjo është vështirësia e madhe për shpresën: kur në një familje apo në një shoqëri apo në një shkollë apo në një grup miqsh të bëjnë të ndiesh se nuk u intereson për ty. Dhe kjo

Vijon në fq. 2 ►

PAPA FRANÇESKU TAKON PATRIARKUN KIRILL NË KUBË



Me 12 shkurt 2016 filloi Udhëtimi i 12 Apostolik i Papa Françeskut për në Meksikë. Në mbrëmje, në aeroportin e kryeqytetit të Kubës, u zhvillua një fakt historik i jashtëzakonshëm: takimi ndërmjet Papa Françeskut dhe Patriarkut të Moskës dhe të të gjithë Rusisë, Kirill.

Vijon në fq. 3 ►

GËZUAR PASHKËT!

Shumë të dashur vëllezër e motra në Krishtin, lajmi i mirë, “Krishti me të vërtetë u ngjalli!”, ju arritë kudo që të jeni dhe jehoftë si lajm i një risie të jashtëzakonshme për jetën e secilit prej jush.

Me Ngjalljen e vet Krishti plotëson misionin e tij si zbulues i fytyrës së

Vijon në fq. 4 ►

PAPA FRANÇESKU NË MEKSIKË

◀ *Vijim i fq. 1*

është e ashpër, është e dhimbshme, por ndodh – a nuk ndodh? Po apo jo? [“Po”]. Ndodh! Kjo na vret, kjo na asgjëson, dhe kjo i hap derën një dhimbjeje të madhe. Por ekzistone dhe një tjetër kërcënim i madh ndaj shpresës – ndaj shpresës që ajo pasuri, e cila jeni ju, të rritet dhe të japë frytin e vet – dhe është të të bëjnë të besosh se ti fillon të vlesh kur maskohesh me veshje, marka, me modën e fundit, ose kur bëhesh prestigjioz, i rëndësishëm sepse ke para, por në fund të fundit zemra jote nuk beson se ti je i denjë për dashuri, dhe këtë zemra e kupton me intuitë. Shpresa bllokohet nga ajo që të bëjnë të besosh, nuk ta lënë që të dalë në pah. Kërcënimi kryesor është kur dikush ndien se paratë i shërbejnë për të blerë gjithçka, përfshirë edhe dashurinë e të tjerëve. Kërcënimi kryesor është të besosh se për faktin se ke një makinë të bukur je i lumtur. Por a është e vërtetë se nëse ke një makinë të bukur je i lumtur?

Ju jeni pasuria e Meksikës, ju jeni pasuria e Kishës. Më lejoni t'ju them një shprehje të tokës sime: no les estoy “sobando el lomo” – nuk jam “duke ju krehur qimen”, nuk jam duke ju lajkatur! Dhe e kuptoj se shumë herë bëhet e vështirë të ndihesh pasuri kur gjendesh vazhdimisht para humbjes së miqve dhe familjarëve në duart e narkotrafikut, të drogave, të organizatave kriminale që mbjellin terror. Është e vështirë të ndihesh pasuri e një kombi kur nuk ke shanse për një punë dinjitoze – Alberti e tha këtë qartë –, kur nuk ke mundësi studimi dhe përgatitjeje, kur nuk i sheh të njohura të drejtat dhe kjo pastaj të bën të shtyresh në situata të skajshme. Është e vështirë të ndihesh pasuri e një vendi kur, për faktin se janë të rinj, ata përdoren për qëllime mesquine duke i joshur me premtime që në fund nuk janë reale, janë flluska sapuni. Dhe është e vështirë të ndihesh i pasur kështu. Pasurinë e keni brenda, shpresën e keni brenda, por nuk është e lehtë, prandaj jam duke ju thënë, dhe edhe ju vetë e keni thënë: mungojnë shanset e punës dhe të studimit – e thanë Roberti e Alberti. E megjithatë, pavarësisht nga të gjitha këto, nuk lodhem duke e përsëritur: ju jeni pasuria e Meksikës.

Robert, ti the një frazë që dua ta ruaj. The se ke humbur diçka. Dhe nuk the: Humba celularin, humba kuletën me para, humba trenin sepse arrita vonë... The: Kemi humbur bukurinë e takimit. Kemi humbur bukurinë e të ecurit së bashku; kemi humbur bukurinë e të ëndërruarit së bashku. Dhe që kjo pasuri, e nxitur prej shpresës, të ecë përpara, duhet të ecim së bashku, duhet të takohemi, duhet të ëndërrojmë! Mos e humbni bukurinë e ëndërrimit! Guxoni të ëndërroni! Të ëndërroni, që nuk është e njëjta gjë si të flini, kjo jo!

Dhe mos mendoni se jua them këtë – se ju jeni pasuria e Meksikës, dhe se kjo pasuri me shpresën ecën përpara – sepse jam i mirë, ose sepse jam ekspert, jo, të dashur miq, nuk është kështu. Jua them këtë, dhe jam i bindur për këtë, a e dini pse? Sepse sikurse ju besoj në Jezun Krishtin. Dhe mendoj se Daniela ka qenë shumë e fortë kur na foli për këtë. Unë besoj në Jezun Krishti, dhe prandaj jua them këtë. Është Ai që e përtërin vazhdimisht në mua shpresën, është Ai që e përtërin vazhdimisht vështrimin tim. Është Ai që zgjon në mua, në secilin prej nesh bukurinë e gëzimit, bukurinë e ëndërrimit, bukurinë e të punuarit së bashku. Është

Ai që vazhdimisht më fton ta kthej zemrën. Po, miqtë e mi, ju them këtë sepse në Jezusin unë kam takuar Atë që është i aftë të ndezë më të mirën e vetes sime. Dhe falë Tij mund të bëjmë rrugë, falë Tij çdo herë mund të rifillojmë nga e para, falë Tij mund të themi: nuk është e vërtetë se e vetmja mënyrë për të jetuar, për të qenë të rinj është ta lëmë jetën në duart e narkotrafikut apo të të gjithë atyre që, e vetmja gjë që janë duke bërë, është të mbjellin shkatërrim e vdekje. Kjo nuk është e vërtetë dhe e themi këtë falë Jezusit. Po ashtu, falë Jezusit, Jezu Krishtit Zot, mund të themi se nuk është e vërtetë se e vetmja mënyrë jetese për të rinjtë këtu është varfëria dhe mënjanimi; mënjanimi prej shanseve, mënjanimi prej hapësirave, mënjanimi prej formimit dhe edukimit, mënjanimi prej shpresës. Është Jezu Krishti Ai që i përgënjeshtroi të gjitha përpjekjet

për t'ju bërë të kotë, ose mercenarë të thjeshtë të ambicieve të të tjerëve. Janë ambiciet e të tjerëve që ju mënjanojnë, për t'ju përdorur në të gjitha ato gjëra që thashë, që i dini, dhe që përfundojnë në shkatërrim. Dhe i vetmi që mund të më mbajë fort për dore është Jezu Krishti. Ai bën që kjo pasuri të shndërrohet në shpresë.

Më kërkua një fjalë shprese: ajo që kam për t'ju thënë, ajo që gjendet në bazën e gjithçkaje, quhet Jezu Krisht. Kur gjithçka duket e rëndë,

kur duket se bota po na shembet përsipër, përqafoni kryqin e tij, përqafoni Atë dhe, ju lutem, mos u shkëputni kurrë prej dorës së tij, edhe nëse ju çon përpara duke ju marrë zvarrë; dhe nëse një herë bini, lejoni që Ai t'ju ngrejë përsëri. Alpinët kanë një këngë shumë të bukur, që mua më pëlqen t'ua përsëris të rinjve, një këngë që këndojnë ndërsa ngjiten: “Në artin e ngjitjes, sukses nuk do të thotë të mos rrëzohesh, por të mos mbetesh i rrëzuar”. Ky është arti. E kush është i vetmi që mund të të kapë për dore që ti të mos mbetesh i rrëzuar? Jezu Krishti, vetëm Ai. Jezu Krishti që, nganjëherë, të dërgon një vëlla që të të flasë e të të ndihmojë. Mos e fshih dorën kur je i rrëzuar. Mos i thuaj: Mos më shiko se jam i baltosur apo e baltosur. Mos më shiko, se tashmë nuk ka më zgjidhje. Vetëm lejo që të të kapë për dore, dhe kape atë dorë, e bukuria që ke brenda, e pistë, e baltosur, e konsideruar si e humbur, do të fillojë, nëpërmjet shpresës, të japë frytin e vet. Por gjithmonë me dorën të shtrënguar me atë të Jezun Krishtit. Kjo është rruga. Mos harro: “Në artin e ngjitjes, sukses nuk do të thotë të mos rrëzohesh, por të mos mbetesh i rrëzuar”. Mos ia lejoni vetes të rrini të rrëzuar! Kurrë! Dakord? E nëse shihni një mik apo një mike që ka pasur një rrëshqitje në jetë dhe është rrëzuar, shko e jepi dorën tënde; por jepja me dinjitet: vendosun pranë tij, pranë saj, dëgjo... Mos thuaj: po të jap recetën! Jo, si mik, me qetësi, jep forcë me fjalët e tua, me dëgjimin tënd: ai ilaç që është duke u harruar: “terapija e dëgjimit”. Lëre të flasë, lër që të të tregojë, e atëherë, pak nga pak, do të të zgjasë dorën, dhe ti do ta ndihmosh në emër të Jezun Krishtit. Por nëse shkon menjëherë, e fillon t'i bësh predikim, e pak nga pak, në fund, të shkretn, e le më keq se sa ishte më parë... A është e qartë? Mos u lodhni kurrë prej dorës së Jezun Krishtit, mos u largoni kurrë prej Tij. E nëse largoheni, ringrihuni dhe ecni përpara: Ai e kupton se çfarë janë



PAPA FRANÇESKU TAKON PATRIARKUN KIRILL NË KUBË

◀ *Vijim i fq. 1*

Një moment i pritur për 600 vjet, përgatitur për shumë kohë me shumë vullnet të mire.

Për ata që janë të interesuar për ecjen ekumenike të të krishterëve për fat të keq të ndarë, lajmi është shumë i gëzueshëm dhe rindez shpresat. “Atë që do të ndodhë – pohonte dje Nunci apostolik i Federatës Ruse, Imzot Ivan Jurkovic – nuk mund ta dimë sepse është shumë shpejt. Do ketë edhe pasoja praktike. Por thjesht vetë fakti i takimit ka nje vlerë simbolike jashtëzakonisht të madhe.”

Në avion Papa ka takuar gazetarët. “Një udhëtim impenjativ, por shumë i dëshiruar – ka thënë- shumë i dëshiruar nga vëllai im Cirillo, nga unë por edhe nga meksikanët. Dëshira ime me e fshehte – ka treguar – është të ndalem para Zojës së Guadalupe, ai mister që studiohet, studiohet dhe nuk ka spjegime njerëzore. Do të shoh sytë e Virgjërës Mari, do t’i



përgjërohem të vazhdojë të na shohë më mëshirë.”

Nga ana e tij Patriarku Kirill i Moskës dhe i gjithë Rusisë, ka mbërritur edhe ai mbrëmë në Kubë, faza e parë e udhëtimit të tij në Amerikën Latine. Shenjtëria e tij – shkruan në një komunikim Patriarku i Moskës – është ftuar nga presidenti Raul Castro. Është hera

e parë që një Patriark i Moskës viziton Amerikën Latine. Pas Kubës, Kirill do të vizitojë Paraguaj-in dhe Brazilin.

Papa dhe Patriarku Kirill, janë takuar privatisht në aeroportin nderkombetar “Jose Marti” te Habanës në oren 14:15 (sipas orës lokale).

Një shenjë dialogu, që vazhdon ndërmjet katolikëve dhe ortodoksëve. Në fund të bashkëbisedimit, kanë firmosur një Deklaratë të

Përbashkët dhe janë larguar rreth ores 17. Pas rreth gjysëm ore, Papa Françesko është nisur për në qytetin e Meksikës.

PAPA FRANÇESKU NË MEKSIKË

◀ *Vijim i fq. 2*

këto gjëra. Sepse së bashku me Jezu Krishtin është e mundur të jetojmë plotësisht, së bashku me Të është e mundur të besojmë se ia vlen të jetojmë; se ia vlen të japim më të mirën e vetvetes, të jemi tharm, kripë dhe dritë mes miqve, në lagje, në bashkësi, në familje – pastaj, Rozario, do të flas pak për atë që the në lidhje me familjen.

Prandaj, të dashur miq, nga ana e Jezusit ju kërkoj të mos lejoni të përjashtoheni, të mos lejoni të përbuzeni, të mos lejoni të trajtoheni si mall. Jezusi na ka dhënë një këshillë për këtë, që të mos lejojmë të përjashtohemi, për të mos lënë të përbuzemi, për të mos lënë të trajtoheni si mall: «Jini të mençur porsì gjarpërinjtë dhe të thjeshtë porsì pëllumbat» (Mt 10,16). Dy virtyte së bashku. Të rinjve gjallëria nuk u mungon; nganjëherë, atyre u mungon mençuria, për të mos qenë naivë. Të dyja gjërat: të mençur por të thjeshtë, të mirë. Sigurisht, me këtë rrugë ndoshta nuk do të keni makinën e modelit të fundit, nuk do ta keni kuletën plot me para, por do të keni diçka që askush nuk do të mund t’ju heqë, pra përvojën e të ndierit të dashur, të përqaftuar dhe të shoqëruar. Është bukuria e takimit, bukuria e ëndërrimit në takimin me të gjithë. Është përvoja e të ndierit familje, e të ndierit bashkësi. Është përvoja e mundësisë për ta shikuar botën në fytyrë, me kokën lart! Pa makinë, pa para, por me kokën lart! Dinjiteti!

Tri fjalë që tani po i përsërisim: pasuria, sepse na është dhënë; shpresa, sepse duam t’i hapemi shpresës; dinjiteti. Të përsërisim: pasuria, shpresa dhe dinjiteti [përsërisin]. Pasuria që Hyji jua ka dhënë ju: ju jeni pasuria e Meksikës; shpresa që ju jep Jezu Krishti; dinjiteti që ju jep të mos lejoni që “t’ju krehin qimen”, dhe të jeni mall për të tjerët.

Sot Zoti vazhdon t’ju thërrasë, vazhdon t’ju kërkojë takim, siç bëri me Juan Diego. Ju fton të ndërtoni një shenjtërore. Një shenjtërore që nuk është një vend fizik, por një bashkësi, një shenjtërore e quajtur famulli, një shenjtërore e quajtur Komb. Bashkësia, familja, të ndierit shtetas është një prej antidoteve kryesore kundër gjithçkaje që ju kërcënon,

sepse na bën të ndihemi pjesë e kësaj familjeje të madhe të Hyjit. Jo për t’u strehuar, për t’u mbyllur, për të ikur nga rreziqet e jetës dhe nga sfidat; madje për të dalë e për të ftuar të tjerët, për të dalë e për t’u shpallur të gjithëve se të jesh i ri në Meksikë është pasuria më e madhe dhe prandaj nuk mund të sakrifikohet. Dhe sepse pasuria është e aftë të ketë shpresë dhe na jep dinjitet. Edhe një herë tjetër tri fjalët: pasuri, shpresë dhe dinjitet. Por ajo pasuri që Hyji na ka dhënë dhe që duhet ta bëjmë të rritet.

Jezusi, Ai që na jep shpresën, kurrë nuk do të na ftonte të jemi vrasës me pagesë, por na quan nxënës, na quan miq. Jezusi kurrë nuk do të na çonte të vdesim, por gjithçka në Të është ftesë në jetë. Një jetë në familje, një jetë në bashkësi; një familje dhe një bashkësi në dobi të shoqërisë. Dhe këtu, Rozario, po i referohem asaj që ti the , një gjë shumë e bukur: “Në familje mësohet afërsia”. Mësohet solidariteti, mësohet bashkëndarja, shoshitja, çuarja përpara e problemeve të njëri-tjetrit, të grindurit dhe të rënit dakord, të diskutuarit dhe të përqaftuarit e të puthurit. Familja është shkolla e parë e kombit, e në familje gjendet ajo pasuri që ju keni. Familja është ajo që e ruan këtë pasuri, në familje mund të gjeni shpresë, sepse aty është Jezusi, dhe në familje mund të keni dinjitet. Kurrë, kurrë mos e lini mënjatë familjen! Familja është guri i këndit i ndërtimit të një kombi të madh. Ju jeni pasuri, keni shpresë dhe ëndërroni... – edhe Rozario ka folur për ëndërrim –: ju a ëndërroni të keni një familje? [“Po”].

Të dashur vëllezër, ju jeni pasuria e këtij Vendi, dhe kur dyshoni për këtë, shikoni Jezu Krishtin, që është shpresa, Ai që i përgënjeshtrohet të gjitha përpjekjet për t’ju bërë të kotë, ose mercenarë të thjeshtë të ambicieve të të tjerëve.

Ju falënderoj për këtë takim, dhe ju kërkoj që të luteni për mua. Faleminderit!

Nga www.vatican.va

URIMET E ARQIPESHKVIT PËR PASHKËT 2016

◀ *Vijim i fq. 1*

mëshirshme të Atit: Ai ka marrë në vete njerëzimin tonë deri në pasojën e skajshme të vdekjes, dhe kështu na ka kthyer në pafajësinë zanafillore, të humbur për shkak të mëkatit. Por pikërisht duke u ngjallur na ka dhënë mundësinë të marrim pjesë në jetën e tij hyjnore.

Të gjithë ne kemi marrë këtë dhuratë tejet të madhe nëpërmjet pagëzimit, por shumë vetë e konsiderojnë atë ende vetëm si një shenjë të përkatësisë në një fe dhe jo si shenjë të përkatësisë në Krishtin. Në të vërtetë, feja, nëse nuk shpreh përkatësinë në Krishtin është e zbrazët dhe pa vlerë.

Jemi duke jetuar një moment hiri të madh në këtë Vit të Mëshirës që papa Françesku e ka dëshiruar kaq shumë: është rasti i volitshëm për të ripërvetësuar fenë tonë, për t'i treguar vetës dhe gjithë botës bukurinë e përkatësisë në Krishtin që na kthen në dashurinë e Atit. Dhe Pashkët janë pikërisht kjo ngjarje e kthimit te Hyji të gjithçkaje që i përket, pra të neve, që jemi shpërblyer prej gjakut të çmueshëm të Krishtit (krh. 1 Pjt 1,18-19) dhe kemi hyrë, së bashku me të, në qiell. Sigurisht, për momentin vetëm shpirtërisht, siç na mëson shën Agustini (krh. Fjalime), por një ditë do të kemi mundësinë ta sodisim atë në lavdinë e tij, faqe faqas.

Prandaj, guxim!

Ty që më dëgjon të them: nëse je në dhimbje mos e lësho veten sepse Krishti ka dashur të marrë mbi vete edhe dhimbjen tënde dhe me ringjalljen e vet të dhuron përsëri shpresën; nëse je në mëkat mos u shkurajo dhe merr rugën e së mirës sepse Pashkët e Krishtit janë kalim prej vdekjes në jetën e mundur për të gjithë; nëse e ardhmja të duket e pasigurt mos u dëshpëro sepse e ardhmja është në duart e Hyjit dhe ai është i mirë e i mëshirshëm.

Shikoni se sa ngjarje hiri Zoti është duke nxitur për popullin tonë në këtë vit Mëshire të vërtetë! Na garantohet falja, na jepet mundësia për të rifilluar vrapimin, por jo vetëm: si bashkësi.

Së fundi, është duke na lejuar të shohim të lartësuar në nderet e altarëve Nënë tonë të dashur Tereza dhe të shpallur të Lumë Martirët tanë. Ja, Martirët tanë janë pikërisht shembulli më shprehës i asaj se si secili prej nesh mund të marrë pjesë në Mundimet e Krishtit që pastaj të marrë pjesë edhe në lavdinë e tij. Ndoshta nuk na kërkohet të vdesim të qëlluar nga një plumb si ata, por sigurisht na kërkohet të vdesim për nga egoizmi ynë, që na bën të mbyllemi në vetvete për t'iu hapur dhurimit të vetvetes nëpërmjet veprave të mëshirshme.

Në lidhje me këtë, dëshiroj t'u drejtohem në mënyrë të veçantë atyre që kanë përsipër përgjegjësinë politike të Vendit, në çfarëdo niveli, duke i ftuar që të kuptojnë dhe të kujdesen për nevojat reale të më të varfërve, një kategori gjithnjë në rritje. Të dashur miq, të zgjedhur prej popullit për t'u kujdesur për të mirën e përbashkët, prej zemrës po ju drejtoj thirrjen që të bëni gjithçka është e mundur për të garantuar të drejtën për punë, krijimin e shanseve të reja për punësim që t'u lejojnë të gjithëve të kenë një vend dinjitoz në shoqëri.

Shën Pali, ungjillëzuesi i parë i kësaj toke, na thotë se nëse jemi ngjallur bashkë me Krishtin duhet të kërkojmë gjërat që janë lart dhe jo këto përmbi tokë (krh. Kol 3,1), por edhe na nxit që të marrim mbi vete peshat e njëri-tjetrit (krh. Gal 6,2) me shpirt bashkëndarjeje.

Të dashur vëllezër e motra, urimi im për këto Pashkë të shenjta, pra, është që askush të mos e bëjë të kotë Ringjalljen e Krishtit, por të bëjë që ajo të shkëlqejë në jetën dhe në veprat e besimtarëve të tij.

Gëzuar Pashkët, vëllezër e motra! Urime.

10 VJET PAS ENCIKLIKËS “HYJI ËSHTË DASHURI”

“DASHURIA NUK MBARON KURRË” (1 KOR 13,8) - PERSPEKTIVA 10 VJET PAS ENCIKLIKËS DEUS CARITAS EST, ka qenë tema e simpoziumit që u bë në Vatikan me 25-26 shkurt 2016, në Sallën e Sinodit. Pjesëmarrësit u takuan me Papa Françeskun. Nga Shqipëria mori pjesë Imzot Angelo Massafra. Në vijm disa mendime nga relacioni i Mons. Toso:

“Të dashur miq, pas dëgjimit dhe reflektimeve po vjen momenti ta mbyllim takimin tonë në këtë sallë. Do të përfundojmë pastaj duke falënderuar Zotin me kremtimin eukaristik të udhëhequr nga kard. Sarah, Presidenti ynë emerito. Por, do të doja të formuloja disa përfundime, në mënyrë që të jap një përmbledhje që mund të na jetë e dobishme për punën tonë brenda secilit prej institucioneve që përfaqësojmë këtu.

1. Ky kongres ka ripohuar aktualitetin e enciklikës Deus caritas est. Pra, nuk është një dokument i së kaluarës, por është një dokument i së tashmes, që ka ruajtur gjithë gjallërinë e vet. Papa tha sot në mëngjes se enciklika “e ruan të paprekur freskinë e mesazhit të vet, me të cilin tregon perspektivën gjithmonë aktuale për ecjen e Kishës”. Në fund të fundit, ideja se misioni i Kishës bazohet në ndërsjellshmërinë mes fjalës, sakramenteve dhe shërbimit të dashurisë, është marrë edhe prej nxitjes apostolike Evangelii gaudium. Aktualiteti i Deus caritas est do të thotë se linjat bazë të përvijuara prej tij nuk e humbin vlerën e vet, por madje

këto linja vazhdojnë të orientojnë, sot edhe me më shumë forcë, shërbimin tonë të dashurisë. Pra, më duket se një rrjedhojë e parë shumë praktike është ta rilexojmë tekstin personalisht dhe të bëjmë që ai të rilexohet brenda organizmave tona. Në këtë mënyrë shpirti i kuvendit tonë do të mund të çohet në secilin realitet që përfaqësojmë, në mënyrë që të gjallërojmë motivimet e angazhimit tonë.

2. Duke hyrë më në thellësi të konkretes, ka disa pika përmbajtjeje që reflektimi i këtyre ditëve na nxit t'i bashkëndajmë. E para është vetë koncepti i dashurisë. Kur Ati i Shenjtë na ka vizituar në Cor Unum, si

dhe sot në mëngjes, duke na pritur, ka theksuar rëndësinë e dashurisë, që, siç ka thënë, “gjendet në qendrën e jetës së Kishës dhe është me të vërtetë zemra e saj”. Kard. Müller tregonte se “dashuria është jeta e Hyjit, që animon bashkësinë e besimtarëve” dhe saktëson se “diakonia si dashuri e Krishtit është shprehje e natyrës së Kishës”. Kard. Tagle theksonte se ndoshta e kemi harruar këtë qendërsi në jetën e Kishës, duke dobësuar kështu vetë shpalljen e Ungjillit dhe jetën sakramentale. Gjithashtu, tepër shpesh e kemi

identifikuar dashurinë me lëmoshën, dhe kjo i ka bërë keq gjithë shërbimit tonë, për dy arsye. Nga njëra anë, e kemi kthyer në një fakt financiar një qëndrim jete, një virtyt të krishterë, madje “emrin e Hyjit”, duke e zbrazur atë në njëfarë mënyre. Nga ana tjetër, kemi qenë të detyruar të huazojmë koncepte jo të krishtera për të shprehur zemrën e

Vijon në fq. 10 ►



NË 70 VJETORIN E MARTIRIZIMIT TË MARK ÇUNIT ME SHOKË

Me 4 mars 2016, në përkujtim të pushkatimit të jezuitëve Atë Daniel Dajani, Rektor i seminarit Papnor në Shkodër, Atë Giovanni Fausti Zv-Rektor, Atë Gjon Shllaku dhe seminaristi Mark Çuni, të laikëve Gjelo Lulashi dhe Qerim Sadikut, u realizua në orën 10 paradite një shtegtim duke u nisur nga shtëpia e Motrave Klarise (që në atë kohë ishte vend paraburgimi) nga u morën të dënuarit e sipërpërmendur për t'i dërguar në vendin e pushkatimit.

Procesionin e drejtonte Imzot Angelo Massafra, i shoqëruar nga famullitari i Rranxave Dom Dritan Ndoci, zv. Rektori i Seminarit të Shkodrës, Dom Gjovalin Simoni, dhe nga disa etër jezuitë dhe meshtarë të tjerë.


I gjithë populli që mori pjesë në këtë ecje, mbarte brenda vetes dhimbjet e tmerrshme që këta martirë përballuan për fe e atdhe.

Rruga vazhdoi drejt Katedrales, ku besimtarët kaluan përmes Derës së Shenjtë dhe hynë brenda në Katedrale për të bërë lutjet që nevojiten për të fituar ndjesën e plotë në këtë vit jubilar të Mëshirës së Zotit.

Më pas të gjithë së bashku u drejtuan për nga varrezat e Rrmajit. Ky segment rrugor ishte ecja e fundit që këta martirë të dashur kishin bërë në këtë botë.

Ndalesa e fundit u bë brenda në varrezë, poshtë çinarit rrëzë të cilit mendohet se u pushkatuan martirët tanë. Aty u lexuan edhe fjalët e fundit që martirët kishin thënë në atë moment të dhimbshëm dhe solemn. Feja dhe dashuria ndaj Zotit që këta martirë kanë dëshmuar në atë mënyrë, me siguri forcojnë fenë dhe dashurinë ndaj Zotit tek secili prej

Çuni. Menjëherë pas dramës, e cila ishte shumë emocionuese, Arqipeshkvi filloi udhën e kryqit, e cila ishte me të vërtetë e veçantë. Në secilën ndalesë lexohej një pjesë e ungjillit sikurse në çdo udhë kryqi të zakonshme dhe më pas një dëshmi e martirëve shqiptarë. Kishte nga ato pjesë që realisht lanë mbresa tek populli dhe që u diskutuan edhe pas mbarimit të udhës së kryqit. Ajo që goditi më shumë ishte një dëshmi mbi Mark Çunin: nëna e Markut kishte arritur të merrte këmbishën e të birit që



kishte të veshur ditën e pushkatimit dhe ashtu me gjakun dhe mishin e Markut e kishte mbajtur deri në vdekje madje e kishte lënë si amanet që të varrosej bashkë me të. Nga përfundimi i kësaj dëshmie sytë e shumë të rinjve, të rriturve dhe sidomos të moshuarve ishin mbushur me dhimbje dhe lotë.

Pas përfundimit të udhës së kryqit të gjithë së bashku u zhvendosëm tek qendra baritore, ku do të mbaheshin disa kumtesa mbi jetën dhe veprën e Markut, mbi rrethanat në të cilat ndodhi pushkatimi i tij, si dhe mesazhin që ai u ka lënë brezave të rinj. Relatorët ishin Atë Mario Imperatori, z. Palokë Rrotani dhe drejtori i shkollës së Rranxave z. Gëzim Muqejani. Ndërkohë u bë edhe prezantimi i librit të përgaditur nga z. Palokë Rrotani mbi Mark Çunin.

Të gjitha veprimtaritë e kësaj dite na kanë nxitur të falënderojmë Zotin për dëshminë e këtyre martirëve, dëshmi të cilat na ftojnë të ndjekim gjurmët e tyre në ndjekjen e Krishtit në jetën tonë të përditshme.

Drilona Rrotani

nesh.


Por, përkujtimi i asaj ngjarjeje, që ka lënë gjurmë tek çdo i krishterë, ata që kanë jetuar atë kohë e gjithë të tjerët që kanë dëgjuar për të, nuk përfundoi vetëm me këtë shtegtim.

Dom Dritan Ndoci, vendosi të realizojë diçka të veçantë në famullinë tonë në përkujtimin e mundimeve të martirëve, e sidomos të martirit Mark Çuni i cili ishte pikërisht nga Rranxat.

Kështu në orën 15.00 në famullinë e Shën Rrokut Bushat u realizua udha e kryqit po në kujtim të këtyre martirëve dhe vuajtjeve të tyre për dashurinë ndaj Krishtit. Aty qenë të pranishëm jo vetëm banorët e famullisë që sigurisht ishin të shumtë në numër, por edhe Imzot Massafra, meshtarë të shumtë të dioqezës, eprorët dhe të gjithë seminaristët e Seminarit Ndërdioqezan Shqiptar së bashku me eprorët e tyre.

Kjo pasdite filloi me një dramë mbi ditën e gjyqit të martirëve dhe të pushkatimit të tyre, e realizuar nga fëmijët e shkollës 9-vjeçare të Rranxave, e cila mban edhe emrin e martirit Mark







ATË DANIEL DAJANI S.J.



ATË GIOVANNI FAUSTI S.J.



SEM MARK ÇUNI



ATË GJON SHLLAKU O.F.M.



GJELOSH LULASHI, LAIK



QERIM SADIKU LAIK

ARQIPESHKVI YNË ME EMIGRANTËT NË TRENTO

E diel, 28 shkurt në kishën e "Santa Maria del Suffragio" në Trento (Itali), Imzot Angelo Massafra, Arqipeshkëv i Shkodër-Pultit (Shqipëri), kremtoi Meshën e Shenjtë në gjuhën shqipe. Falenderojmë Don Robertin, rektor i kishës.

Katolikët shqiptarë në Trentino patën gëzimin të kishin mes tyre Arqipeshkvin Massafra, i cili shkon për t'i takuar, që t'u japë zemër e këshilla, sa herë që shkon në Itali për angazhime të tjera.

Kështu edhe në javën e tretë të Kreshmëve, në Vitin e Mëshirës, jo vetëm u bënë lutje, por edhe u fol shumë edhe për problemet e shumta që shqetësojnë bashkësinë shqiptare emigrante. Në kremtimin e Meshës së shenjtë ishte i pranishëm një diakon shqiptar i Kosovës, që gjendet në seminar për të vazhduar formimin shpirtëror, teologjik dhe baritor, Don Meriton Dedaj, duke shpresuar që, me lejen e eprorëve, të mund të na ndihmojë në animimin e krishterë të katolikëve shqiptarë.

Gjatë Meshës së Shenjtë Imzot Massafra u lut për Imzot Luigi Bressan duke falënderuar për miqësinë dhe solidaritetin ndaj të gjithë emigrantë e dhe u lut për Imzot Lauro Mauro Tisi, Ipeshkëv i emëruar, që Zoti ta ndihmojë në detyrën e re që i ka besuar Ati i Shenjtë.

Familjet janë duke kaluar kohë të vështira prej mungesës së punës, problem që është duke krijuar pakënaqësi dhe shtim shqetësimi. Ka edhe familje që deri tani kishin një jetë normale dhe që u është dashur ta

modifikojnë jetën e tyre të përditshme dhe të heqin dorë nga disa gjëra. Duket se jeta që ëndërronin në këtë vend dhe për të cilën kanë emigruan rrezikon të mos realizohet...

Bashkësia është seriozisht e shqetësuar për të ardhmen dhe ia tregon këtë Ipeshkvit të vet, i cili këshillon që të kenë durim, kthjelltësi e qëndrueshmëri, dhe sidomos i fton të formojnë bashkësinë qoftë mes vetë shqiptarëve qoftë me emigrantët e tjerë dhe sidomos me trentinët në rrugën e integritit, sepse vetëm kështu kapërcehen vështirësitë.

Në vjeshtën e këtij viti, kujtoi Imzot Massafra, kemi dy ngjarje të mëdha që e bëjnë Kishën Katolike Shqiptare krenare për bijtë e vet: Shenjtërimi i së Lumes Nënë Tereza e Kalkutës dhe Lumturimi i Imzot Vinçenc Prennushit e 37 Shokëve, Shërbëtorë të Hyjit, të vrarë gjatë

regjimit komunist *in odium fidei* (për urrejtje ndaj fesë).

Ipeshkvi u këshilloi shqiptarëve të vazhdonin në ecjen e tyre të fesë gjatë këtyre kreshmëve duke kremtuar Udhën e Kryqit dhe duke i ftuar që të ndiqnin traditën e bukur të të devotshëmve të Shna Ndout të Padovës, kremtimin e 13 të martave si përgatitje për festën e 13 qershorit, ashtu siç bëhet në Shqipëri. Arqipeshkvi Imzot Massafra këshilloi që të ruheshin dhe t'u përçoheshin brezave të rinj traditat tona të bukura.

Leonora Zefi

JEMEN: VRITEN 4 MOTRA TË NËNË TEREZËS
NË NJË SULM TËRRORIST

Në Jemen 4 murgesha Misionare të Bamirësisë, Kongregacioni i themeluar nga Nënë Tereza e Kalkutës, janë vrarë nga nje komandë burrash të armatosur që ka sulmuar këtë mëngjes kuvendin e tyre, në qytetin Aden. Përveç murgeshave, kanë mbetur të vrarë nga sulmi tërrorist edhe 10 bashkëpunëtorë të tjerë të komunitetit, nderkohë që i ka shpëtuar vdekjes Superiorja e Kuvendit.

Dy nga murgeshat e vrara, ishin ruandeze, një indiane dhe e katërta vinte nga Kenia. Në keto çaste eprorja e Kuvendit, po i jep informacione policisë, që mban në vëzhgim trupat e motrave te ndjera dhe të viktimave të tjera.

Janë te gjithë gjallë, edhe pleqtë dhe të paaftit e pritur në Komunitet, nderkohë që sulmuesit kanë rrëmbyer Padër Tom Uzhunnalil, një meshtar salezian indian që jetonte ne strukturë, i cili në momentin e sulmit ishte në kapelë duke u lutur. Meshtari gjendej në kuvend, pasi Kisha e Familjes së Shenjtë në Aden, ku ndodhej prifti ishte sulmuar dhe djegur nga flakë të vëna nga burra të armatosur të paidentifikuar, shtatorin e kaluar.

Për Imzot Paul Hinder, vikar apostolik i Arabisë së Mesme që ka dhënë lajmin, "sinjali është i qartë: behet fjalë për diçka që ka të bëjë me fenë, me besimin." "Ne e dinim që situata ishte e vështirë- vazhdon më tej – dhe motrat edhe në të shkuarën kanë qenë objekt i dëshiruar i sulmeve dhe rrezikonin" Gjithesi, shton ai, "kishin vendosur të

qëndronin çfarëdo që të ndodhte, sepse kjo bën pjesë në përshtypshërimin e tyre. Për të tjerat ishte e qartë që "zona nuk është e sigurt", edhe pse nuk keni patur lajmërim te veçanta dhe sepse është e vështirë të kesh lajme në këtë vend.

Papa Françesko: Motrat e vrara në Jemen, martiret e indiferencës.

Motrat e nënë Terezës të vrara në Jemen, janë martiret e sotshme, por nuk përbëjnë lajm. Siç është pohuar nga Papa në sheshinn e Shën Pjetrit, ku edhe një herë ka denoncuar globalizimin e indiferencës, nder shkaqet që ushqejne luftërat.

Shenja të paqes, shenja të mëshirës që edhe pse arrijnë në sakrificën e jetës, nuk përbëjnë lajm. Papa Françesko, kujton me fjalë të ndjeshme Misionaret e Bamirësisë, të vrara në një sulm barbar në Jemen, ku ndihmoheshin të varfërit. Siguron

lutje për ta dhe familjarët e tyre dhe më pas bën një denoncim drithërues: "Këta janë martiret e sotshme! Nuk janë kopertina gazetash, nuk janë lajm: keta japin gjakun e tyre për Kishën. Keta persona janë viktima të sulmit të atyre që i vranë dhe janë viktima dhe të indiferencës, të këtij globalizimi të indiferencës, të cilëve nuk ju intereson... Nënë Tereza i shoqëroftë në Parajsë, këta bijat e saj martire të bamirësisë, dhe qoftë ndërmjetëse për paqen dhe respektin e shenjtë të jetës njerëzore"

Kronisti



DËSHMITARË TË MËSHIRËS



Katekeza për të rinj dhe universitarë në kohën e Krezhmeve tashmë është bërë traditë në Dioqezën tonë për një ecje të mirëfilltë drejt Pashkës. Katekezat e udhëhequra nga vetë Arqipeshkvi Imzot Angelo Massafra dhe bashpunëtorët e tij, kanë përcjellë tek të rinjtë, përveç mesazhit të thellë e kuptimplotë, edhe afërsinë e Bariut me të rinjtë dhe vlerësimin e ecjes shpirtërore të tyre. Vlerësimi dhe përgjigjja e të rinjve gjatë takimeve ka dëshmuar dëshirën për të qënë pjesë e një Kishe në ecje, e një formimi me themele të forta dhe me një kulturë ugjillore të integruar në realitetin ku jetojmë.

Të ftuar për të qënë dëshmitarë të Mëshirës, të rinjtë janë bërë pjesë e katër takimeve të organizuar rreth Fjalës, rreth një dëshitari/e që ka përjetuar dhe dëshmuar Mëshirën e Hyjit si edhe rreth një bashkëbisedimi apo bashkëndarje mes të rinjve. Arqipeshkvi ka shpjeguar dhe shtjelluar më së miri Fjalën e Zotit gjatë gjithë takimeve dhe figura e një dëshmitari/e është shpjeguar nga bashpunëtorët të ndryshëm.

Në takimin e parë në muajin shkurt, është folur për Ungjillin e Mateut, 9,9-13, pikërisht për thirrjen e Mateut. Si dëshmitari i këtij takimi të parë, jo rastësisht, është propozuar figura e të madhit Shën Françesku i Asizit. Përsone i Shën Françeskut është bërë model edhe për shenjtër të tjerë gjatë historisë së kishës, dhe jo vetëm kaq, është model i mëshirës së Hyjit. Fra Gazmend Tinaj ka shpjeguar shumë mirë figurën e Shën Françeskut duke treguar

ndër të tjera edhe kthimin e të gërbulurit falë dashurisë së dëshmuar nga Françesku.

Takimi i radhës ka parë si protagonist një tjetër shenjt të madh të Kishës, Shën Vinçenc de Paoli, misionar i dashurisë së Zotit. Atë Agostini, vinçencian, ka shpjeguar më së miri konferencat shpirtërore të Shën Vinçencit dhe veprën e tij që vazhdon nëpërmjet bijve dhe bijave shpirtërore. Pjesa e Ungjillit të Markut, 2, 1-12, shërimi i të pikuarit, i parapriu Dëshmitarit të Dashurisë, duke vendosur theksin pikërisht tek përpjekja e çdo përsone për t'u angazhuar në shenjtëri dhe për të qënë dëshmitarë të papërtueshëm të Mëshirës.

Në takimin e tretë është folur për Letrën e parë të Timoteut, 1,12-17, vetë Pali tregon thirrjen e tij si një falenderim Hyjit për atë që ka bërë në jetën e tij. *E falënderoj Atë që më dha fuqi - Krishtin Jezus, Zotin tonë - pse më çmoi të besueshëm duke më thirrur në shërbesë mua, që më parë isha blasfemues, salvues, arrogant. Por gjeta mëshirë pse veproja prej padijes, larg nga besimi i vërtetë. Dhe hiri i Zotit tonë që pa masë i begatshëm bashkë me fe dhe me dashuri që është në Krishtin Jezus* (1Tim, 1,12-14). Dëshmia e Motër Marjetës, eprore e Misionareve të Bamirësisë në Shkodër, ka prekur shumë të rinjtë, jo vetëm për fjalët që tha, por mbi të gjitha për dhëshminë dhe punën e madhe që bëjnë. Pak ditë pas vrasjes së katër motrave në Yemen dhe pak ditë para shpalljes së datës së shenjtërimit të së lumes Nënë Tereza, të rinjtë e pranishëm nuk bënë asnjë pyetje por duartrokitën dëshminë e gjallë të dashurisë dhe e shoqëruan ato me disa minuta Adhurim e lutje.

Në takimin e katërt dhe të fundit, mbas shpjegimit të letrës drejtuar



Hebrenjve të bërë si gjithmonë nga Imzot Angelo Massafra, Atë Artani foli për figurën e Shën Faustines. Në ditarin e saj, ndër të tjera, Shën Faustina theksont: “Bija Ime, shikoje humnerën e Mëshirës Sime dhe jepi nder e lavdi Kësaj Mëshire në këtë mënyrë; mbliidhi të gjithë mëkatarët e mbarë botës dhe zhyti në humnerën e Mëshirës Sime. Dëshiroj Të Dhurohem për shpirtërat, bija Ime. Në ditën e festës Sime, në festën e Mëshirës, do të kalosh nëpër mbarë botën e do të sjellësh shpirtërat e thatë tek burimet e Mëshirës Sime, unë do t'i shëroj dhe do t'i forcoj” (Ditari f. 65). Takimi përfundoi duke u lutur me kurorëzën e Mëshirës Hyjnore.

Katekezat për të rinj dhe univesitarë në këtë kohë Krezhmesh kanë qënë një mundësi e mirë përgaditjeje për Pashkë. Në të njëjtën kohë, Fjala e Zotit dhe modeli i Shenjtërve, kanë qënë për të rinjtë një palestër e mirë për t'u bërë dëshmitarë të Mëshirës në ditët e sotme, në vendin ku jetojmë e punojmë dhe në mesin e bashkëmoshatarëve.

Motër Rita Ndoci

LUTJA 24 ORE ME ZOTIN NË KATEDRALE

Në të dytin vit radhazi, thirrjes së papa Françeskut për të rezervuar një ditë-natë të vecantë adhurimi, meditimi, soditje nën moton “24 orë me Zotin”, ju përgjigj edhe famullia e Shkodrës duke organizuar këtë përshpirtëri.

Përgaditjet e para filluan përmes një takimi paraprakë me të gjithë entet, famullitë, shtëpitë e motrave etj, të cilët veprojnë brenda territorit të qytetit Shkodër. Pasi u diskutua për mënyrën sesi do të organizohej kjo nisëm e Papës, u vendos që cdo bashkësi të ketë një orarë që do të drejtojë e animojë në thellimin e lutjes dhe meditimit, por gjithashtu që i Shejtnueshmi Sakrement të mos ngelej vetëm në asnjë moment.

Pas Meshës së ores 16.00 të premtës së datës 4 Mars, i Shenjtnueshmi Sakrement u shfaq para besimtarëve, me këtë gjest filloi adhurimi “24 orë me Zotin”. Kisha Katedrale qëndroi e hapur gjatë gjithë kohës, familje, grupe të organizuara, besimtarë të rastësishëm shfrytëzuan me dëshirë këtë klimë lutjeje.

Gjatë gjithë kohës së adhurimit, meshtarë të Shkodrës pritën në rrëfystore besimtarët që donin të rrefeheshin.

Nisma “24 orë me Zotin”, përfundoi të shtunën e datës 5 mars në orën 16.00 me Meshën e shenjtë, e kremtuar nga Imzot Angelo Massafra.

Falënderojmë të gjithë grupet që u angazhuan në këtë iniciativë, familjet e besimtarët e ndryshëm, që së bashku krijuam një ditë-natë të veçantë adhurimi në këtë vit Mëshire e historik për popullin Shqiptar!

Dom Artur Jaku



UDHA E KRYQIT NË TARABOSH

Famullia e Shën Shtjefnit Shkodër, ditën e shtunë dt. 12.03.2016 në vazhdimësi të traditës tashmë prej disa vitesh zhvilloi Udhën e Kryqit në malin e Taraboshit.

Shumë fëmijë, të rinj, të reja dhe të moshuar qenë pjesë në këtë përshpirtëri të Udhës së Kryqit. Një turmë e madhe njerëzish po shkonte pas Kryqit duke ndjekur në mënyrë simbolike të njëjtën udhë që Jezusi ndoqi deri në vendin e kryqëzimit.

Kryqi u mbajt nga njëra ndalesë në tjetrën nga të rinjtë e grupeve të ndryshme që bashkëpunojnë në famullinë tonë. Udhë e Kryqit u udhëhoq nga famullitari Dom Artur Jaku. Gjithashtu nuk mund të mungonte as prania e Ipeshkvit të dioqezës Shkodër-Pult, Imzot Angelo Massafra.

Duke u përpjekur për të përjetuar udhën e mundimeve të Zotit tonë Jezu Krishtit të gjithë ishim të ftuar që të shqyrtonim zemrat tona. Si dhe gjatë 40 ditëve të kohës të krezhmës duhet të përgatisim zemrën tonë për të pritur sa më denjësisht ngjalljen e Zotit.

Dom Artur Jaku



DITA E TË SËMURËVE

Sëmundja, sidomos ajo që është më e rëndë, vë në krizë ekzistencën e njeriut duke sjellë shumë pikëpyetje: së pari rebelim, pse më ndodhi, ndihesh i dëshpëruar, gjithçka mbaroi, tashmë asgjë nuk ka vlerë,...në këto situatë, nga njëra anë është besimi në Zot i vënë në prove, por që zbulon gjithë forcën e tij pozitive. Jo se besimi e zhdruk sëmundjen, dhimbjen apo pikëpyetjet që lindin, por sepse ofron një çelës me të cilin mund të zbulojmë në thellësi atë çfarë jemi duke jetuar; një çelës që na ndihmon të kuptojmë se sëmundja është një rrugë për t'u afruar me Jezusin që na shoqëron ne ngarkuar me kryqin e tij. Citon Papa Francesku ne mesazhin drejtuar në Ditën Botërore të të Sëmurëve dhe Punonjësve të Shëndetësisë: 11 shkurt 2016.

Caritasi Dioqezan Sektori i Shëndetësisë, në bashkëpunim me Famullinë Shen Shtjefni, Projektin Shpresa, Madonnina Del Grappa, Qendra Shtetërore e Zhvillimit kanë organizuar aktivitetet e kësaj dite. Mesha e Shenjtë është kremtuar në Katedralen Shën Shtjefni në orën 15.00 me një pjesëmarrje të madhe të besimtarëve. Një pjesë e madhe e tyre të sëmurë të shoqëruar nga familjarët e tyre por edhe nga Motrat e Nënë Terezës, Motrat Vinçenciane, Motrat Stigmatine etj, të cilat edhe janë të angazhuara në këto shërbime. Mesha u kremtua nga Dom Artur Jaku, i cili në homelinë e tij ndër të tjera falenderoi të gjithë ata që kontribuojnë dhe kujdesen për të sëmurët por gjithashtu iu drejtua gjithë punonjësve të shëndetësisë: jini të mëshirshëm, pasi duke u shërbyer të sëmurëve i keni shërbyer Zotit..

Ne fakt në dioqezën tonë kemi shumë shërbime shëndetësore, fizioterapie, dhe shtëpi familjeje me persona me aftësi ndryshe. Shërbimet janë falas dhe ofrohen nga Motrat Franceskane të Krishtit Femijë, Madonnina Del Grappa, Projekti Shpresa, Komuniteti Papa Giovanni XXIII, Motrat Nënë Tereza, Misionarët e Bamirësisë, Motrat Vincenciane, Motrat Punëtoret e Vogla të Zemrave të Shenjta, Motrat Françeskane të Krishtit

Mbret, Motrat Skalabriniane, Motrat Salvatoriane, Motrat Françeskane Misionare të Suzës. Përgjegjëse e Shëndetësisë në dioqezë është Dr. Motër Enza Ferrara.

Në këto qendra disa herë në vit ofrohen mjekë të huaj specialistë për të ofruar vizita dhe shërbime falas, në favor të personave në nevojë dhe atyre që kanë një diagnozë që nuk kurohet në Shqipëri. Kryesisht janë fëmijë me diagnoza cardiopatie dhe dërgohen për kurim falas në Itali, i vetmi shtet i cili që para shumë viteve ka pranuar të kurojë falas të sëmurë shqiptarë.

Pas Meshës së Shenjtë në Sallën Mikel Koliqi të gjithë bashkë morëm pjesë në një program artistik me pjesëmarrjen e Grupeve të Projektit Shpresa, të Motrave të Nënë Tereza, Madonnina Del Grappa, grupit të vullnetarëve të Famullisë Shën Shtjefni dhe të vullnetarëve të Caritas (Rinia Vullnetare Universitare). Të ftuar special

kishim Orkestrën The Door e cila përformoi disa pjesë instrumentale.

Mesazhi “ **Si Jezusi me dhembshurinë e tij**” u përcoll shumë bukur në këtë ditë. Para së gjithash duke përkujtuar Don Carlo Zaccaro dhe

Silvana Vignali që shumë vite më parë me shumë kurajo dhe vështirësi filluan ta zbatonin me punë konkrete këtë mesazh, në Shqipërinë postkomuniste, duke hapur dhe promovuar shtëpi familje, laboratore pune, qendra integruese jo vetëm për t'u siguruar kushte më të mira, por edhe për të treguar se edhe fëmijët apo të rinjtë me aftësi të kufizuar mund ta përballojnë jetën sikurse të gjithë moshatarët e tyre, kur ato përfshihen në ato struktura të cilat i krijojnë kushtet për të shfaqur aftësitë e veta.

Falenderojmë të gjithë organizatorët dhe protagonistët që kontribuan vullnetarisht në realizimin e të gjitha aktiviteteve të kësaj dite, Si Jezusi me

Jolanda Marena



dhembshurinë e tij....

10 VJET PAS ENCIKLIKËS “HYJI ËSHTË DASHURI”

◀ *Vijim i fq. 4*

krishterimit. Këtu kemi kujtuar se dashuria është vetë Hyji, dhe si i tillë është dëftuar Hyji i krishterë: prandaj dashuria mbetet për gjithmonë. Kemi marrë fjalët e shën Palit për këtë kuvend: “Dashuria nuk mbaron kurrë”. Dashuria është edhe qëllimi, sepse njeriu është i thirrur të marrë pjesë në jetën trinitare që është dashuria. Prandaj mbetet e vlefshme ftesa e drejtuar të gjithëve ne për të rizbuluar dhe ripërdorur në kuptimin e vet më të plotë konceptin e dashurisë. Në secilën gjuhë ka pasur një variacion semantik: por nga ana jonë mund të angazhohemi për ta përdorur konceptin në domethënien e vet më të plotë, sepse shpreh pikërisht origjinën hyjnore të dashurisë, pra të shërbimit tonë. Pikërisht sepse shpreh plotësinë e domethënies së asaj që bëjmë, ndoshta është mirë ta rimarrim termin edhe në emërtimin e zyrave përkatëse që drejojnë këtë sektor të Kishës. Nuk mjafton të themi shoqëroë për të përkufizuar shërbimet tona, por do të duhej të thoshim pikërisht bamirëse.

Deus caritas est pohon se është Hyji ai që na kërkon për të realizuar të

mirën tonë. Ashtu sikurse Hyji na kërkon për të mirën tonë – dhe na kërkon i pari –, po ashtu edhe ne kërkojmë njeriun për të realizuar të mirën e tij. Pikërisht prej kësaj analogjie me sjelljen e Hyjit del në pah se sa thelbësore është feja në shërbimin tonë, sepse ajo përfshihet në vetë dinamikën e Hyjit dhe na ndihmon ta shohim tjetrin me vetë sytë e Hyjit. Bëhet fjalë për ta bërë tonën dashurinë e Hyjit për ta dhuruar pastaj atë. Këmbëngulja në këtë aspekt të fesë të shërbimit tonë nuk është për arsye të një çështjeje të thjeshtë identiteti, a thua se duhet të shkëputemi apo të dallohemi prej të tjerëve, por me qëllim që secili prej nesh të marrë qëndrimin e Hyjit ndaj njeriut të cilit i shërben. Do të thotë mirëkuptim, liri, durim. Do të thotë të kërkojmë të mirën e personit dhe të të gjithë personatë. Në fe, të marrim vështrimin e Hyjit drejtuar njeriut do të thotë edhe të kemi një vision të njeriut ashtu sikurse Hyji na e ka zbuluar...

*Mons. Giampietro Dal Toso
Sekretar i Këshillit Papnor Cor Unum*

LAJME NGA DIOQEZA E SAPËS

PËRVJETORI I 70-TË I MARTIRIZIMIT

70 Vjetori i Pushkatimit të Atë Daniel Dajanit & Atë Giovanni Fausti (4 mars 1946 - 2016)

Në ditët e para të marsit të 2016-es, famullia e Shën Shtjefnit në Blinisht zhvilloi disa kremtime në përkujtim të 70 vjetorit të pushkatimit të klerikëve, Atë Daniel Dajani, Atë Giovanni Fausti dhe seminaristit Mark Çuni, të cilët u akuzuan nga regjimi komunist i kohës si organizatorë dhe pjesëmarrës në organizatën “Bashkimi shqiptar” Gjatë këtyre ditëve u mbajtën lutje e adhurim në çdo fshat të kësaj famullie. Ndërsa në vigjilje të këtij përvjetori, besimtarët e të gjashtë fshatrave u mbledhën në qendrën e famullisë për të kujtuar e nderuar figurën e lavdishme të martirëve, e ndritur me gjakun e tyre.

Në këtë vigjilje, me ftesë të famullitarit don Enzo Zago, Arqipeshkvi i Shkodrës Imzot Angelo Massafra mbajti ligjëratën mbi “*Kanonizimin e martirëve Shqiptarë, historinë dhe domethënien*”. Ndërsa përcolli edhe lajmin që Papa Françesku dhe Selia e Shenjtë gjatë këtij viti do të përmbyllë procesin e martirizimit të martirëve shqiptarë dhe do të shpallen të Lumturit e Kishës Katolike. Duke kujtuar martirët, u shfaq edhe filmi-dramatizim mbi jetën dhe veprën e meshtarëve të pushkatuar, realizuar nga seminaristët e Seminarit Ndërdioqezan të Shkodrës, Zoja e Këshillit të Mirë.

Në ditën e 4 marsit, Ipeshkvi i Sapës, Imzot Lucjan Avgustini kremtoi Meshën e Shenjtë, përmes së cilës kujtoi se, kjo ditë është një dhuratë e mirësisë dhe dashurisë së Zotit ndaj nesh falë punës dhe

sakrificave të meshtarëve dje dhe sot. Kujtojmë martirët tanë tha ai, të cilët dhanë jetën e tyre duke dëshmuar besimin në Krishtin, dashurinë dhe faljen ndaj armiqve.

Imzot Lucjani solli disa fjalë të kujtimit të Atë Daniel Dajanit, i cili i rezistoi çdo vuajtjeje dhe poshtërimit, saqë e dha jetën për Krishtin.

“Duke kujtuar Atë Dajanin, nuk mund të mos kujtojmë edhe Atë Giovanni Faustin dhe seminaristin Mark Çunin, pohoi Ipeshkvi, të cilët, sipas dëshmitarëve që e përjetuan ngjarjen e 4 marsit të vitit 1946, do të dëshmonin: “po udhëtonin në kamionin e vdekjes nga burgu deri tek varrezat e Rrmajit në qyetetin e Shkodrës. Nuk u dridhej buza, nuk u ngushtohej zemra. Udhëtonin të qetë drejt amshimit. Ashtu të rreshtuar pranë njëri-tjetrit, lidhur dorë më dorë si një kurorë ku gërshetoheshin zhguna e veledona, rregulltarë e besimtarë, puthën kryqin e shëlbimit dhe shqiptuan fjalët e fundit”. Para pushkatimit Atë Fausti do të thoshte: “Jam i lumtur

që po vdes në krye të detyrës sime. Rrnoftë Krishti Mbret.

Atë Dajani do të thoshte: “I fali ata që më kanë ba keq”! Po kështu edhe Mark Çuni. E pasi i pushkatuan, të tre u rrëzuan duke njomur edhe një herë me gjak atë tokë që me gjak ishte lagur prej shekujsh.



NË JUBILEUN E MËSHIRËS 24 ORË ME ZOTIN

Në prag të së dieles së katërt të krezhmeve, në kuadër të iniciativës “24 orë me Zotin”, lançuar nga Këshilli Papnor për Ungjillizimin e Ri, ashtu si në të gjitha dioqezat e mbarë botës, edhe Dioqeza e Sapës me kishat famullitare të saj, organizoi ditë lutjeje dhe adhurimi në datat 4 e 5 mars 2016.

“24 orë me Zotin”, është një nismë kjo e vendosur nga vetë Ati i Shenjtë Papa Françeku, që nga koha e krezhmeve të vitit 2014, dhe ka për qëllim që t'i dedikohet sakramentit të pajtimit, iu dedikohet të gjithë njerëzve vullnetmirë që dëshirojnë t'i drejtohen adhurimit eukaristik.

Në dokumentin “Misericordiae Vultus” Papa shkruan: “*Nisma 24 orë me Zotin është rritja shpirtërore në të gjitha dioqezat. Shumë njerëz janë duke u tërhequr më afër sakramentit të Pajtimit dhe në mesin e tyre shumë të rinj, të cilët shpesh e gjejnë veten në atë përvojë rruge për t'u kthyer kah Zoti, për të jetuar një moment lutjeje intensive dhe të rizbulojnë kuptimin e jetës së tij. Ne kemi vënë përsëri në qendër sakramentin e Pajtimit, shkruan Papa, sepse kjo ju mundëson për të prekur madhështinë e*



mëshirës . Ajo do të jetë për çdo njeri burim i pendimit dhe i paqes së vërtetë të brendshme”.

Adhurimi eukaristik u mbajt në kapelen e Shtëpisë së Bamirësisë në Vau-Dejës, i cili filloi nga ora 06 e mëngjesit deri në orën 24.00 të së premtes së 4 marsit. Nën kujdesin e famullisë së Shën Kollit, besimtarë të grupmohave të ndryshme, dhe grupet e lutjeve morën pjesë në oraret e tyre të caktuara, të cilët me pendesë dhe uratë u bashkuan në sakramentin e rrëfimit, Pajtimit me Zotin, adhuruan të shenjtërueshmin sakrament, u lutën sipas njeteve, por edhe sipas qëllimeve të nxitura nga viti i mëshirës, për Mëshirën, Faljen, Pajtimin dhe Dashurinë vëllazërore. Adhurimin eukaristik e ndoqi herë pas here edhe vete Ipeshkvi, Imzot Lucjan Avgustini. Kjo nismë lutjeje nxiti edhe më shumë përforcimin e jetës shpirtërore dhe zbulimin e fytyrës së Hyjit, Atit të Mëshirshëm Qiellor.

Violeta Marashi

FOTO KRONIKË



**ME 19 MARS IMZOT MASSAFRA
KREMTOI MESHËN DHE BEKOI BUKËN
NË 150 VJETORIN E SHËN JOZEFIT
SI PAJTOR I SAN MARZANOS**



Teatër "Migjeni" 16 Nëntor 2015



facebook

HAPËSIRË MEDIATIKE

Regjistrohu në kanalin tone!

NgjarjetKishaKatolikeShkoderPult

Do të gjesh video të ngjarjeve
më të rëndësishme të dioqezës



Drejtues
Imzot Angelo Massafra

Redaksia
Arqipeshkvia

Lektore
Emanuela Marku Matija

Faqesia
Luigj Mila

Shtypshkronja
"Gjergj Fishta"
Lezhë